

VENDIM
Nr. 21, datë 22.4.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi dhe Enina Kotoni, në datat 12.12.2024, 3.2.2025, 5.3.2025, 19.3.2025, 2.4.2025 dhe 10.4.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen nr. 11 (E) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Elton Qyno, përfaqësuar nga avokat Dorian Matlija, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Bledar Maksuti dhe Ols Dado.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 501, datë 13.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për paraqitjen e të dhënave elektronike të kërkuarit, si dhe çdo akti procedural të prodhuar si pasojë e zbatimit të këtij vendimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 04 (87-2024-9), datë 6.1.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-255 (36), datë 20.2.2024, të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i papajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare i vendimeve nr. 500 dhe 502, datë 13.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për kontrollin e banesës, paraqitjen e të dhënave elektronike dhe kontrollin personal të kërkuarit, si dhe çdo akti procedural të prodhuar si pasojë e zbatimit të këtyre vendimeve; i vendimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, zbatuar sipas procesverbalit “Për sekuestrimin e sendeve”, datë 14.12.2023, ora 00:05.

Shkatërrimi i të gjitha kopjeve të imazheve të hard disqeve të kompjuterëve dhe USB, si dhe ekstrakteve të memorieve të telefonave celularë dhe kartave SIM të nxjerra nga pajisjet e sekuestruara, si dhe rezultatet e fiksuara prej tyre.

Marrja e masave deri në shkatërrimin e plotë të të gjitha kopjeve të imazheve të hard disqeve të kompjuterëve dhe USB, si dhe ekstrakteve të memorieve të telefonave celularë dhe kartave SIM të nxjerra nga pajisjet e sekuestruara, si dhe ndalimi i çdo aksesimi eventual, kryerja e çdo procedure filtrimi dhe/ose përzgjedhjeje e të dhënave, si dhe nxjerrja e kopjeve të tjera.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 22, 36, 37, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 8, 10 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 17 dhe 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (*PNDKP*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Elton Qyno (*kërkuari*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme, në kuadër të procedimit penal nr. 75 të vitit 2022 (*procedimi penal nr. 75/2022*), ka hetuar kryerjen e 27 veprave penale të rënda kundër jetës dhe pronës nga një grup i strukturuar kriminal i përbërë nga 34 persona, prej të cilëve 21 janë proceduar nën masën e sigurimit “Arresti në burg”. Procedimi penal aktualisht është në fazën e gjyqimit në shkallë të parë pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*).

2. Byroja Kombëtare e Hetimit (*BKH*) ka referuar pranë Prokurorisë së Posaçme se të dhënat sekrete hetimore të procedimit penal të mësipërm ishin zbuluar në kundërshtim me ligjin dhe një pjesë e tyre ishte publikuar edhe në media. Mbi bazën e materialit të referuar, në datën 12.12.2023 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 245 të vitit 2023 për veprat penale “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete” dhe “Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 295/a, paragrafi i tretë dhe 313/b, paragrafi i parë, të Kodit Penal (*KP*). Me vendimin e së njëjtës datë të dyja procedimet penale janë bashkuar në një të vetëm me nr. 75/2022.

3. Kërkuari është gazetar në një medie audiovizive. Në datat 10.12.2023 dhe 11.12.2023 në faqen e internetit të medias audiovizive janë publikuar disa artikuj, që sipas referencave janë shkruar nga kërkuari. Artikujt përmbajnë pjesë të komunikimeve që një bashkëpunëtor i drejtësisë (aktualisht i pandehur) ka bërë me disa persona (të paidentifikuar ende nga hetimet) në platformën e enkriptuar Sky ECC. Bisedat e bëra publike në media janë pjesë e akteve sekrete të hetimit paraprak, por të padokumentuara ende në akte procedurale nga ana e Prokurorisë së Posaçme.

4. Të nesërmen e regjistrimit të procedimit penal nr. 245/2023, konkretisht në datën 13.12.2023 kërkuari është thirrur në Prokurorinë e Posaçme për t’u pyetur se si ishte vënë në dijeni të materialeve që përbënin sekretet hetimor. Prokuroria e ka pyetur kërkuarin bazuar në nenet 159, 297 dhe 312 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) për identifikimin e burimit të informacionit. Fillimisht kërkuari është paralajmëruar për të mos publikuar në vazhdim materiale të tjera që i përkisnin hetimit dhe më pas është pyetur për të treguar përmbajtjen e dokumentit të gjetur dhe burimin që ia ka siguruar këtë informacion. Kërkuari ka refuzuar zbulimin e burimit të informacionit, me argumentin se ai është sekret profesional i gazetarit.

5. Në këto kushte, bazuar në nenet 202, 202/a, 203, 205, pika 4, 206, 207 dhe 208 të KPP-së, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur përpara GJKKO-së së Shkallës së Parë tri kërkesa dhe konkretisht: i. për lejimin e kontroleve në banesën e kërkuarit dhe vendin e punës ku ushtron detyrën e gazetarit, me qëllim për të kërkuar, gjetur, marrë e sekuestruar sende dhe prova materiale që lidhen me veprën penale (*kërkesa e parë*); ii. për lejimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në banesë dhe vendin e punës, duke kërkuar, hyrë, nxjerrë dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimin e të dhënave ose të sistemit kompjuterik (*kërkesa e dytë*); iii. për lejimin e kontrollit personal të gazetarit për të gjetur sende e prova materiale që lidhen me veprën penale (*kërkesa e tretë*).

6. Në lidhje me *kërkesën e parë*, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 500, datë 13.12.2023 (*vendimi nr. 500/2023*), ka vendosur pranimin e saj dhe lejimin e kontroleve në banesë dhe në vendin e punës. Në pikën 5 të dispozitivit të vendimit gjykata është shprehur se kundër vendimit nuk lejohet ankim. Në ekzekutimin e këtij vendimi, në datën 13.12.2023, ora 20:00, në banesën e kërkuarit janë sekuestruar një hard disk i jashtëm, një njësi qendrore e kompjuterit, një zarf, 9 USB, 6 CD dhe një telefon. Pas katër ditëve kërkuarit i janë kthyer 6 CD, veprim që është dokumentuar me procesverbalin e datës 27.12.2023.

7. Për sa i përket *kërkesës së dytë*, me vendimin nr. 501, datë 13.12.2023 (*vendimi nr. 501/2023*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin e saj dhe lejimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik në vendin e punës ku gazetari ushtron detyrën dhe në banesën e tij, duke kërkuar, hyrë, nxjerrë dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose sigurimin e të dhënave, ose të sistemit kompjuterik. Ajo gjykatë ka arsyetuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm se janë konsumuar veprat penale, ndaj është e domosdoshme marrja e të dhënave në sistemin kompjuterik në funksion të hetimit dinamik të procedimit për të identifikuar personin përgjegjës për nxjerrjen e akteve sekrete hetimore, të cilat janë sensitive në drejtim të pasojës dhe për të ruajtur rendin e sigurinë publike nga publikimi i informacionit. Sipas gjykatës së shkallës së parë, liria e shprehjes nuk duhet të cenojë të drejtën për të jetuar të punonjësve të institucioneve të drejtësisë, sigurinë publike dhe dinamikën e hetimeve.

8. Në ekzekutim të vendimeve nr. 500/2023 dhe nr. 501/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, me të cilat ishin disponuar kontrollet, si dhe sekuestrimi i të dhënave kompjuterike, në datën 13.12.2023, ora 22:30, janë sekuestruar në vendin e punës së kërkuarit një njësi qendrore e kompjuterit, një CD, një mandat arkëtimi dhe një letër me shënime. Pas 1 muaji e 18 ditëve, kërkuarit i është kthyer njësi qendrore e kompjuterit, veprim i cili është dokumentuar me procesverbalin e datës 30.1.2024.

9. Ndonëse kërkuari ka paraqitur apel, vendimi nr. 501/2023 është miratuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) me vendimin nr. 04 (87-2024-9), datë 6.1.2024 (*vendimi nr. 4/2024*) dhe nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2024-255 (36), datë 20.2.2024 (*vendimi nr. 36/2024*).

10. GJKKO-ja e Apelit, në referim të vendimit njësuës nr. 147, datë 23.11.2021, të Gjykatës së Lartë (*vendimi njësuës nr. 147/2021*), ka vlerësuar se sekuestrimi i të dhënave kompjuterike është i ligjshëm, pasi ekziston fakti penalisht i ndëshkueshëm i dhënies së informacioneve që kanë lidhje me një bashkëpunëtor të drejtësisë gjatë hetimit penal. Informacionet e publikuara përmbanin të dhëna sensitive që vinin në rrezik integritetin fizik dhe lirinë e bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe personave të tjerë. Ato informacione janë sekret hetimor dhe sigurojnë administrimin e mirë të drejtësisë dhe parimin e prezumimit të pafajësisë. Sipas gjykatës së apelit, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike ka si qëllim të identifikojë personat përgjegjës për nxjerrjen e akteve sekrete, të ruajë fshehtësinë e hetimeve, si dhe të mbrojë jetën, integritetin fizik dhe lirinë e dëshmitarëve të pyetur dhe të bashkëpunëtorit të drejtësisë. Në këto rrethana, shprehet gjykata e apelit, sekuestrimi respekton kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, sepse është me ligj, për interes publik dhe nuk cenon parimin e proporcionalitetit, pasi interesi publik i mbrojtur tejkalon të drejtën e mbrojtjes së burimit të gazetarit. Po kështu, gjykata e apelit ka vlerësuar se edhe sekuestroja nuk ka dëmtuar garancitë për sinjalizuesit e mundshëm, pasi publikimet në media nuk kanë të bëjnë me raportimin e sjelljeve të dyshuara të korrupsionit, joetike ose të jashtëligjshme, për të cilin sinjalizuesi do të gëzonte mbrojtje sipas ligjit. Sekuestroja, ka çmuar gjykata e apelit, nuk cenon as të drejtën për jetë private, e cila nuk është absolute. Edhe pretendimi se kërkuari nuk është thirrur në seancën për urdhërimin e sekuestros, sipas gjykatës së apelit, është i pabazuar, pasi të drejtat e individit realizohen gjatë gjykimit në shkallë të dytë, ndaj procesi gjyqësor në tërësi i jep mundësinë personit të prekur të vërë në vend të drejtën e tij.

11. Ndërsa Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vendimmarrja e gjykatave të faktit është në përputhje me ligjin procedural penal dhe pretendimet për cenimin e parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes që sekuestrimi ka bërë te liria e shprehjes, janë të pabazuara. Sipas Gjykatës së Lartë, të dhënat

kompjuterike janë provë materiale, ndaj sekuestrimi i tyre ishte i domosdoshëm dhe në përputhje me ligjin për të verifikuar faktin penal të nxjerrjes së akteve sekrete hetimore dhe identifikuar autorët në burimin më të afërt dhe imediat. Në analizë të balancës ndërmjet interesit për të hetuar menjëherë pa pengesa dhe konfidencialitetit të burimeve të gazetarit prevalon i pari. Përmbajtja e publikimeve të kërkuarit, shprehet Gjykata e Lartë, nuk e justifikon interesin publik të përgjithshëm. Po kështu, sipas Gjykatës së Lartë, nisur nga fakti se kërkuarisi është në pozitë të personit që ka dënim për veprën penale dhe jo të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, prokuroria nuk ka ndalim për të zbatuar të gjitha mjetet procedurale. Gjithashtu, sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat më të ulëta kanë interpretuar drejt vendimin njësoj nr. 147/2021, si dhe kriteret e KEDNJ-së për kufizimin e të drejtave themelore.

12. Në lidhje me *kërkesën e tretë*, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 502, datë 13.12.2023 (*vendimi nr. 502/2023*), ka vendosur pranimin e saj dhe lejin e kontrollit personal të kërkuarit, me qëllim gjetjen e sendeve ose provave materiale që lidhen me veprën penale. Në pikën 5 të dispozitivit të vendimit gjykata është shprehur se kundër vendimit nuk lejohet ankim. Në ekzekutimin e këtij vendimi, në datën 13.12.2023, ora 17:43, kërkuarisi i janë sekuestruar një çelës automjeti, i cili rezultoi t'i jetë kthyer të nesërmen (dokumentuar me procesverbalin e datës 14.12.2023) dhe në orën 18:55 një USB, që i është kthyer pas 5 ditëve (dokumentuar me procesverbalin e datës 28.12.2023).

13. Përveç tri kërkesave të mësipërme, në datën 13.12.2023, ora 22:00, me aktin “Autorizim për lejin e përdorimit të pajisjes teknike, gjurmuese (IMSI Catcher)”, Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenet 75/a shkronja “b”, 221, pikat 2 e 3/a dhe 222, pika 8, të KPP-së, ka autorizuar përdorimin e pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes për të lokalizuar numrin e telefonit të kërkuarit. Hetuesit e BKH-së në datën 14.12.2023, ora 00:05, kanë sekuestruar në ambientin e brendshëm të një subjekti tregtar dy aparate telefonike, veprim i cili është dokumentuar me procesverbal. Sekuestrimi është vleftësuar i ligjshëm nga Prokuroria e Posaçme me vendimin e datës 14.12.2023. Me vendim të të njëjtës datë, Prokuroria e Posaçme ka vendosur ekspertimin tekniko-kompjuterik të dy aparateve telefonike, duke caktuar edhe një ekspert.

14. Në datën 18.12.2023 kërkuarisi i është drejtuar sërish GJKKO-së së Shkallës së Parë me kërkesë për heqjen e sekuestros provuese për sendet e marra në datën 13.2.2023 gjatë kontrollit të banesës së tij (një hard disk, një njësi qendrore e kompjuterit, zarf, 9 USB, 6 CD dhe një telefon); gjatë kontrollit të zyrës (një njësi qendrore e kompjuterit, një CD, fletë mandati); gjatë kontrollit të automjetit (një USB); gjatë kontrollit në një ambient tregtar pranë Prokurorisë së Posaçme (dy telefona). GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 507, datë 27.12.2023, ka vendosur kthimin e USB-së së sekuestruar në automjetin e tij, me arsyetimin se ishin tejkaluar kufijtë e kontrollit personal. Gjithashtu, ajo gjykatë ka vendosur zbatimin e urdhrin të prokurorisë për kthimin e disa sendeve në datën 25.12.2023 dhe rrëzimin e kërtimeve të tjera. Për sa u përket pretendimeve për kthimin e telefonave celularë, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se veprimi i prokurorisë është i mbështetur në ligj dhe në prova, duke theksuar se mbajtja e tyre është e domosdoshme për vijimin e hetimit, ndaj nuk mund t'i kthehen kërkuarit. Ndonëse kërkuarisi ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 24 (87-2024-33), datë 1.2.2024.

15. Për rekursin e kërkuarit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-515 (76), datë 25.3.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim. Gjykata e Lartë ka mbështetur argumentin e gjykatës së apelit se aparatet telefonike janë sende dhe jo sisteme kompjuterike, ndërsa për sa u përket sendeve të sekuestruara në banesë, përfshirë CD dhe kompjuterin, është shprehur se gjykata e apelit duhet të kishte verifikuar pretendimin për cenimin e jetës private dhe të dispononte kthimin e materialeve që lidheshin me jetën e fëmijëve ose të familjes. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit nuk ka verifikuar nëse ndër sendet e sekuestruara ka CD me përmbajtje të jetës personale e familjare ose nëse kompjuterët e sekuestruar në banesë kanë qenë në funksion të lojërave të fëmijëve. Për këtë arsye, sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit duhet të verifikonte nëse mbajtja nën sekuestro e sendeve (mjete të punës) të gazetarit ishte e nevojshme dhe nëse prokuroria mund të zbatonte nenin 208/a, paragrafi 3, shkronja “b”, të KPP-së për marrjen

e të dhënave kompjuterike, si dhe paragrafin e parë të nenit 213 të po këtij kodi, për marrjen e dokumenteve. Ndërsa për sa i përket sekuestrimit të aparateve telefonike, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kërkuesi ka marrë përgjigje të argumentuar se ato përbëjnë sende dhe jo sisteme kompjuterike.

16. Pas rigjykimit të çështjes, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 95 (87-2024-137), datë 21.5.2024, ka vendosur sërish miratimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

17. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur rekurs, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2157 (311), datë 16.12.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me plotësimin: “Sendet e sekuestruara dhe të pakthyera duhet t’i kthehen kërkuesit brenda datës 16.2.2025.”. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ligjshmëria e sekuestrimeve ishte verifikuar në një proces tjetër nga gjykatat e posaçme dhe Kolegji Penal i saj. Në vijim, sipas Gjykatës së Lartë, për shkak të kohëzgjatjes prej 1 viti dhe në bazë të parimit të proporcionalitetit, prokuroria duhet të përfundonte analizat ose ekzaminimet teknike dhe t’i kthente sendet kërkuesit brenda datës 16.2.2025.

18. Në datën 14.6.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, duke kërkuar në thelb shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për lejimin e kontroleve personale dhe të vendeve (banesë dhe vendi i punës), vendimeve gjyqësore për sekuestrimin e provave materiale (sende dhe të dhëna kompjuterike) dhe vendimit të prokurorit për sekuestrimin e dy aparateve telefonike. Po kështu, ai ka kërkuar edhe zbatimin e vendimit të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së dhe pezullimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore, konkretisht të veprimeve të përpunimit të imazheve dhe të të dhënave kompjuterike në pajisjet e sekuestruara. Me vendimin e datës 17.7.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 23.7.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve me përparësi. Me vendimin e po kësaj date, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore, me arsyetimin se Komiteti për të Drejtat e Njeriut i OKB-së i ka kërkuar shtetit shqiptar të ndalojë kryerjen e çdo inspektimi, shpërndarjeje ose përpunimi gjyqësor të materialeve të sekuestruara nga kërkuesi dhe në kushtet kur vendimet e këtij komiteti duhet të respektohen, nuk ka shkak të përsëritet marrja e të njëjtave masa.

19. Në datën 3.3.2025 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e objektit të ankimit, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike; konstatimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve gjyqësore për lejimin e kontroleve personale dhe të vendeve, si dhe të vendimit të prokurorisë për sekuestrimin e dy aparateve celulare; shkatërrimin e të gjitha kopjeve të imazheve dhe ekstrakteve të hard disqeve dhe aparateve telefonike, si dhe rezultatet e fiksuarat prej tyre; marrjen e masave për shkatërrimin e plotë të tyre dhe ndalimin e aksesit ose kryerjes së çdo procedure filtrimi, përzgjedhje të të dhënave dhe nxjerrje të kopjeve të tjera.

20. Gjykata, në seancën plenare të datës 5.3.2025 mbi bazë të dokumenteve, duke konstatuar nevojën për përcaktimin e fakteve të çështjes, ka vendosur të ndryshojë formën e shqyrtimit të çështjes nga seancë plenare mbi bazë të dokumenteve në atë publike, me pranimë e palëve. Në seancën plenare publike të datës 19.3.2025 Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës për ndryshimin e objektit të ankimit kushtetues individual, siç përcaktohet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

21. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se aktet dhe vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

21.1. *Lirinë e shprehjes*, të garantuar nga neni 22 i Kushtetutës, neni 10, paragrafi 2, i KEDNJ-së dhe nenet 17 dhe 19 të PNDKP-së, pasi ndërhyrja nuk ka pasur qëllim legjitim dhe nuk ka qenë proporcionale, për arsyet e mëposhtme:

21.1.1. Nuk përmbushet kriteri i qëllimit legjitim, sepse nuk është vërtetuar nëse zbulimi i burimit të informacionit të gazetarit është e vetmja mënyrë për të provuar veprën penale. Liria e shprehjes mund të kufizohet kur ekziston nevoja për një hetim, pasi janë shteruar mundësitë e tjera hetimore. Të dhënat e kërkuara nga prokuroria mund të nxirren nga burime të tjera dhe në rastin konkret burimi i gazetarit, i cili dëmton konfidencialitetin e tij, nuk është i domosdoshëm.

21.1.2. Urdhri i Prokurorisë së Posaçme parashikon ndalimin e publikimit të deklarimeve të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, por nuk përfshin edhe aktet e dosjes hetimore ose komunikimet elektronike. Asnjë gazetar tjetër i cili ka publikuar këto të dhëna ose persona të përfshirë në hetime, nuk u janë nënshtruar sekuestrimeve si rasti i kërkuesit.

21.1.3. Urdhri i gjykatës është formuluar në terma të gjerë dhe ka lejuar sekuestrimin e çdo pajisjeje elektronike, duke u mundësuar hetuesve që të zbulojnë burimet dhe të hyjnë pa kriter në të gjitha të dhënat. Po kështu, mungojnë masat për të mbrojtur konfidencialitetin e burimeve gazetareske dhe informacioneve që nuk lidhen me çështjen. Kontrolli dhe aksesit i të dhënave ka ndodhur pa praninë e avokatit të kërkuesit dhe gjykatat kanë vënë në rrezik jo vetëm marrëdhëniet me burimet e gazetarit, por edhe sinjalizuesit e mundshëm që punojnë në institucionet shtetërore. Sekuestrimi i pajisjeve rrezikon edhe sekretet profesionale dhe personale të gazetarit.

21.1.4. Pajisjet e sekuestruara janë sisteme kompjuterike dhe mbartin të dhëna kompjuterike, ndërsa organi i akuzës i ka konsideruar ato si sende. Nëse do të ishin të tilla, ato do të sekuestroheshin vetëm për marrjen e gjurmëve të gishtave, por në fakt sekuestrimi është bërë për të siguruar të dhënat kompjuterike prej tyre, të cilat duhen mbrojtur në rastin e gazetarit profesionist. Qëllimi i masave është ndëshkimi i kërkuesit për publikimin e artikujve në media. Po kështu, ndërsa kryheshin sekuestrimet e materialeve personale dhe profesionale, kërkuesi është mbajtur i mbyllur me çelës për disa orë në ambientet e prokurorisë.

21.1.5. Prokuroria e Posaçme ka aluduar se kërkuesi ka kryer krim dhe po abuzon me imunitetin profesional, ndërsa gjykatat e kanë trajtuar rastin sikur gazetari të ishte i pandehur dhe akuzohej për një vepër penale që ishte në tejkalim të lirisë së shprehjes. Gjykata e Lartë ka analizuar balancën midis së drejtës së gazetarit për të mbrojtur burimet përkundrejt fshehtësisë së hetimit, kur në fakt ajo duhet të analizonte në drejtim të balancës e nevojës për ndërhyrje të prokurorisë dhe të gjykatës në raport me të drejtën e mbrojtjes së burimeve të gazetarit.

21.1.6. Prokuroria dhe gjykatat nuk kanë respektuar vendimet e Komitetit për të Drejtat e Njeriut në OKB për ndalimin e përpunimit dhe të shpërndarjes së informacionit të sekuestruar. Edhe Avokati i Popullit, nisur nga rasti i kërkuesit, ka publikuar një raport për respektimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore.

21.2. *Të drejtën e jetës private*, të garantuar nga neni 35 i Kushtetutës, neni 8 i KEDNJ-së dhe neni 17 i PNDKP-së, pasi sekuestrimi i pajisjeve elektronike krijon mundësi për akses në sekrete të jetës private, por edhe profesionale për shkrime që kërkuesi është duke përgatitur për median ku punon. Pajisjet elektronike të sekuestruara janë mjetet e punës së tij të përditshme, si dhe përdoren edhe nga fëmijët e tij të mitur.

21.3. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi kërkuesi është mbajtur i izoluar në prokurori për 6 orë pa justifikim. Ai nuk është thirrur e dëgjuar në seancën gjyqësore për t'u urdhëruar nga gjykata të tregojë burimin dhe as në seancën gjyqësore të sekuestrimit. Sipas nenit 159, paragrafi 3, të KPP-së, është gjykata e cila urdhëron gazetarin të tregojë burimin e informacionit dhe jo prokurori, sikurse ka ndodhur. Gjykata duhet të thërriste kërkuesin dhe të vlerësonte nëse të dhënat ishin të domosdoshme dhe nuk mund të siguroheshin në mënyra të tjera. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë për lejimin e sekuestrimit është menjëherë i ekzekutueshëm dhe ankimi kundër tij nuk është efektiv, pasi nuk mund të rivendosen në vend të drejtat. Vendimet e kundërshtuara nuk kanë respektuar vendimin njësuës nr. 147/2021, i cili ka përcaktuar kriteret që duhet të analizojnë gjykatat për të lejuar sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Procedura e sekuestrimit të pajisjeve në ambientet e punës dhe të banimit është nisur pa praninë e

mbrojtësit. Gjykimi i çështjes është kryer në kushtet e konfliktit të interesit, pasi prokurorët ishin të njëjtët me ata që dyshohen për veprat penale, për të cilat është urdhëruar sekuestrimi.

22. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

22.1. Pretendimi për cenimin e *lirisë së shprehjes* nuk është i bazuar. Të tria gjykatat kanë kthyer përgjigje shteruese, duke argumentuar se ekzistojnë dyshime për veprime penale, pasi publikimi i artikujve përmbante të dhëna sensitive që mund të identifikonin personat e përfshirë në hetime dhe të rrezikonin jetën dhe integritetin e tyre, përfshirë bashkëpunëtorin e drejtësisë. Fshtësia e hetimeve prevalon mbi interesin për të informuar publikun. Kufizimi i *lirisë së shprehjes* është bërë në përputhje me ligjin dhe është i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Publikimet në media nuk lidhen me bërjen publike të një raportimi ose praktike të dyshuar korrupsioni, sjelljeje joetike ose të jashtëligjshme, ose çështje të tjera të mbrojtura nga ligji për sinjalizuesit. Interesi publik për ruajtjen e fshtësisë së hetimeve prevalon mbi mbrojtjen e burimeve të gazetarit dhe ndonëse gazetarët duhet të jenë të lirë të raportojnë ngjarjet, kërkuesi nuk ka bërë verifikime të mjaftueshme përpara publikimit të informacionit. Sekuestrimi i sendeve ka si qëllim vetëm marrjen e informacioneve që bëjnë të mundur zbulimin e të dhënave që mund të çojnë në identifikimin e personave përgjegjës të cilët kanë nxjerrë aktet sekrete të hetimit, me qëllim ndjekjen penale të tyre. Publikimi i të dhënave nuk ishte rezultat i një investigimi të një çështjeje me interes publik, pasi nuk shoqërohet me asnjë analizë gazetareske, por thjesht publikim i pjesëve të transkriptimit të bisedave midis bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe të dyshuarve të tjerë për veprat penale.

22.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së jetës private* nuk qëndron, pasi, siç kanë arsyetuar gjykatat e zakonshme, e drejta për jetë private nuk është absolute, por duhet të balancohet me funksionin dhe nevojat e shoqërisë; ndërhyrja është në përputhje me ligjin, përbën një masë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe është bërë për qëllime të ligjshme. Gjykatat e zakonshme kanë analizuar balancën midis së drejtës për jetë private të gazetarit dhe nevojës për të mbrojtur informacionet e ndjeshme relevante për hetimin, duke arritur në përfundimin se gjatë procedurave të kontrollit janë respektuar të drejtat dhe dinjiteti i kërkuesit. Ky i fundit nuk ka paraqitur prova bindëse që tregojnë shkelje; ndërhyrja në të drejtën e jetës private ka pasur qëllim mbledhjen e provave për çështjen penale dhe jo cenimin e privatësisë të të miturve.

22.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi, sikurse kanë pohuar gjykatat e zakonshme, gjykimi nga gjyqtari i hetimit paraprak zhvillohet pa pjesëmarrjen e palës së interesuar, por personi i prekur ka të drejtën e ankimit menjëherë pas marrjes dijeni për sekuestron. Kjo procedurë nuk cenon standardin kushtetues të aksesit efektiv në gjykatë, kontradiktoritetin, si dhe të drejtën për t'u dëgjuar, pasi ato realizohen gjatë gjykimit në shkallë të dytë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

23. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

24. Për sa i takon legjitimitimit *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individ mund të bëjë ankim

kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me të drejtat themelore të tij, duke treguar se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore dhe të prokurorisë, të cilat kanë lejuar kontrollin personal, të vendit të punës dhe të banesës së tij, si dhe sekuestrimin e sendeve dhe të dhënave kompjuterike, me pretendimin se ato akte kanë ndërhyrë drejtpërdrejt në të drejtat themelore të tij. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi justifikon interesin në çështjen e parashtruar, ndaj legjitimohet *ratione personae*.

26. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet për ato vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të të drejtave. Ky rregull, në thelb, synon t'u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të zakonshme mundësinë e parandalimit ose korrigjimit në substancë të shkeljeve të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimet gjyqësore dhe të prokurorisë, që kanë lejuar kontrollin dhe sekuestrimin, nuk kanë vendosur për themelin e akuzave, por janë vendime të ndërmjetme të procedimit penal në funksion të mbledhjes së provave për faktin penal. Në jurisprudencën kushtetuese, vendimet e ndërmjetme të sekuestros konservative ose preventive, të dhëna gjatë hetimeve paraprake, i janë nënshtruar kontrollit kushtetues, edhe pse gjykimi i themelit të fajësisë ende nuk kishte përfunduar, duke u konsideruar si vendime përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Për këto lloj vendimesh, Gjykata është shprehur se ndonëse me karakter të përkohshëm dhe nuk vendosin për themelin e çështjes, ato ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale dhe, për rrjedhojë, konsiderohen me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për sa u përket vendimeve të ndërmjetme për kontrollin, Gjykata vëren se KPP-ja nuk parashikon të drejtën e ankimit ndaj tyre, por vetëm ndaj vendimeve të sekuestrimit të provave materiale gjatë kontrolleve (nenet 202–212, 407 dhe 420 të KPP-së). Gjykata çmon se ligjvënësi duhet të vlerësojë nëse duhet plotësuar legjislacioni procedural penal për t'i ofruar individit mjetet juridike efektive për kundërshtimin përpara gjykatave të zakonshme të masës së kontrollit të vendeve ose atij personal edhe në rastin kur kontrolli nuk shoqërohet me masën e sekuestrimit, për sa kohë që kontrolli mbart në vetvete mundësinë për të cenuar të drejtat dhe liritë themelore. Megjithatë, duke iu referuar parashikimeve aktuale ligjore, Gjykata vë në dukje se kur gjatë kontrollit sekuestrohen prova materiale, atëherë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit parashtrohen nga individit në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë dhe pas shterimit të atyre mjeteve juridike ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual. Nëse nga kontrolli nuk gjenden sende për t'u sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe individit i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherë ai mund t'i paraqesë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit drejtpërdrejt në Gjykatë me anë të ankimit kushtetues individual.

29. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesi ka kundërshtuar pesë vendime gjyqësore dhe një vendim të prokurorisë, konkretisht: i. vendimin nr. 500/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, për lejimin e kontrollit në vendin e punës dhe në banesën e tij, ku janë sekuestruar prova materiale, vendim i paankimueshëm në gjykatat më të larta; ii. vendimin nr. 501/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike në vendin e punës dhe në shtëpi; iii. vendimin nr. 502/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë për lejimin e kontrollit personal, në zbatim të të cilit është kontrolluar edhe automjeti i tij, ku janë sekuestruar prova materiale, vendim i paankimueshëm në gjykatat më të larta; iv. vendimin nr. 4/2024 të GJKKO-së së Apelit, me të cilin është lënë në fuqi vendimi për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike në vendin e punës dhe në

banesë; v. vendimin nr. 36/2024 të Gjykatës së Lartë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së apelit për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike në vendin e punës dhe në banesë; vi. vendimin e datës 14.12.2023 të Prokurorisë së Posaçme për vleftësimin e sekuestrimit të dy aparateve telefonike në një ambient tregtar.

30. Nga analiza e këtyre akteve dhe mbi bazën e standardeve kushtetuese për shterimin e mjeteve juridike në rastin e kontroleve dhe të sekuestrimeve, Gjykata vëren se kërkuesi ka hapur dy procedura ankimore në gjykatat e zakonshme. Në të dyja këto procedura ai ka ngritur pretendimet për cenimin e lirisë së shprehjes, së drejtës për jetë private dhe atë të procesit të rregullt ligjor.

31. Procedura e parë lidhet me ankimet (apel dhe rekurs) ndaj vendimit nr. 501/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike gjatë kontrollit në banesë dhe në vendin e punës, kontrole të lejuara me vendimin nr. 500/2023 të së njëjtës gjykatë. Në këtë procedurë ankimore GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë, respektivisht me vendimet nr. 4/2024 dhe nr. 36/2024, kanë vendosur miratimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këto pretendime.

32. Procedura e dytë ankimore ka të bëjë me kërkesën për heqjen e sekuestros ndaj provave materiale të sekuestruara gjatë kontrollit personal, të lejuar me vendimin nr. 502/2023 dhe gjatë zbatimit të të cilit është kontrolluar edhe automjeti i kërkuesit; provave të tjera materiale, të ndryshme nga të dhënat kompjuterike, të sekuestruara gjatë kontrollit në banesë dhe në vendin e punës, të lejuar me vendimin nr. 500/2023 të së njëjtës gjykatë; dhe dy aparateve telefonike të sekuestruara nga Policia Gjyqësore në një ambient tregtar, sekuestrim që është vleftësuar i ligjshëm nga Prokuroria e Posaçme me vendimin e datës 14.12.2023. Shqyrtimi gjyqësor i kërkesës për heqjen e sekuestros ndaj këtyre provave materiale ka përfunduar në datën 16.12.2024, kur Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve të gjykatave të faktit për rrëzimin e kërkesës, me plotësimin e urdhërimit për kthimin e sendeve të sekuestruara kërkuesit brenda datës 16.2.2025 (*shih paragrafin 17 të vendimit*). Pas komunikimit të këtij vendimi kërkuesi ka mbajtur qëndrimin me shkrim dhe verbalisht në seancë plenare, që Gjykata nuk duhet të kontrollojë kushtetutshmërinë e tij, pasi synon të paraqesë ankim tjetër kushtetues individual brenda afatit ligjor 4-mujor, afat i cili ende nuk ka përfunduar. Në këto rrethana, Gjykata, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, çmon se pretendimet që lidhen me sendet e sekuestruara gjatë këtyre kontroleve, përfshirë sekuestrimin e dy aparateve telefonike në një ambient tregtar, nuk mund të shqyrtohen në këtë gjykim kushtetues, për shkak se procesi ankimor në gjykatat e zakonshme për kundërshtimin e këtyre vendimeve ka përfunduar në datën 16.12.2024, pra pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual dhe se kërkuesi synon të paraqesë ankim tjetër kushtetues individual për atë proces.

33. Për sa më lart, Gjykata evidenton se objekti i gjykimit kushtetues kufizohet në kontrollin kushtetues të tre vendimeve gjyqësore (vendimet nr. 501/2023, nr. 4/2024 dhe nr. 36/2024) që kanë lejuar sekuestrimin e të dhënave kompjuterike të nxjerra nga provat materiale të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës dhe të vendit të punës së kërkuesit, pavarësisht se vetë provat materiale, nga të cilat janë nxjerrë të dhënat kompjuterike, janë sekuestruar me vendimin tjetër gjyqësor (vendimi nr. 500/2023).

34. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procedurën e ankimit në gjykatat e zakonshme, mban datën 20.2.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 14.6.2024. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

35. Në seancën plenare të datës 10.4.2025, gjatë diskutimit përfundimtar, kërkuesi ka paraqitur për herë të parë pretendimin se izolimi i tij prej 6 orësh i ka cenuar lirinë personale, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së. Në vlerësimin e Gjykatës, ky pretendim i ri, në thelb, ndryshon shkaqet e ankimit kushtetues individual, duke shtuar një shkak të ri pas kalimit të çështjes në seancë plenare. Për rrjedhojë, Gjykata, në të njëjtën linjë qëndrimi që ka mbajtur edhe në çështje të

ngjashme (*shih vendimin nr. 4, datë 21.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese*), çmon se pretendimi për cenimin e lirisë personale nuk mund të merret në shqyrtim, sepse duhet të respektojë kriteret e përgjithshme të formës dhe të afateve të paraqitjes, të cilat i nënshtrohen fillimisht procedurës së shqyrtimit paraprak.

36. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi ai është mbajtur i izoluar për 6 orë në datën 13.12.2023 në ambientet e Prokurorisë së Posaçme dhe gjykata e shkallës së parë e ka dhënë vendimin për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike në një proces në mungesë të tij. Po sipas tij, vendimi gjyqësor i sekuestrimit është menjëherë i ekzekutueshëm dhe ankimi kundër tij nuk është efektiv, pasi nuk mund të rivendosen në vend të drejtat e cenuara. Për këtë pretendim subjekti i interesuar ka prapësuar duke iu referuar arsyetimit të GJKKO-së së Apelit, sipas të cilit kjo lloj procedure nuk cenon standardin kushtetues të aksesit efektiv në gjykatë, kontradiktoritetit dhe të drejtën për t'u dëgjuar, pasi ato realizohen gjatë gjykimit në shkallë të dytë, ndaj procesi gjyqësor në tërësi i jep mundësinë personit të prekur të vërë në vend të drejtën e tij.

37. Gjykata rithekson se procedurat gjyqësore që vendosin për kërkesat e prokurorit gjatë hetimit paraprak, të cilat ndërhyjnë në të drejtat themelore, si rregull, duhet të sigurojnë garancitë e duhura të procesit të rregullt për individin. Megjithatë ligji i ka kufizuar disa prej garancive të procesit të rregullt në këtë fazë në raport me ato të gjykimit të themelit. Kështu, kur liria personale kufizohet nga caktimi i masës së sigurimit të arrestit, ligji ka kufizuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, (në drejtim të thirrjes së dëshmitarëve apo marrjes së provave), i cili nuk zbatohet në të njëjtën masë dhe mënyrë si në gjykimin e themelit (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ky këndvështrim, Gjykata pohon se ligjvënësi në këto raste, duke mos parashikuar dëgjimin e individit dhe një debat kontradiktor përpara gjyqtarit të hetimit paraprak, si dhe duke mos i dhënë efekt pezullues ankimit, ka synuar që masa të tilla hetimore, siç janë sekuestrimet e provave materiale, të mos pengohen nga individit me anë të taktikave të ndryshme në drejtim të zhdukjes ose dëmtimit të provave materiale. Në këtë mënyrë sigurohet efektiviteti i masës, për rrjedhojë edhe rezultati i procedimit penal në tërësinë e tij. Për këtë arsye, garancitë e procesit të rregullt realizohen në gjykimin në shkallë të dytë, ku gjykata e apelit, e cila ka edhe kompetencën e marrjes dhe të shqyrtimit të provave, krahas zbatimit të ligjit, i jep mundësinë individit që ai vetë ose avokati i tij të dëgjohet dhe të kundërshtojë kushtet në të cilat janë caktuar ose zbatuar masat hetimore. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të procedimit në mungesë të tij në shkallë të parë dhe ekzekutimit të menjëhershëm të vendimit të sekuestrimit është haptazi i pabazuar.

38. Kërkuesi në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae* ka pretenduar gjithashtu cenimin e lirisë së shprehjes dhe së drejtës për jetë private, të garantuara nga nenet 22 dhe 35 të Kushtetutës. Për sa kohë pretendimi lidhur me cenimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor u vlerësua haptazi i pabazuar, Gjykata në vijim do të analizojë lirinë e shprehjes dhe të drejtën për jetë private në aspektin substancial.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë së shprehjes

39. Kërkuesi ka pretenduar se sekuestrimi nuk ishte e vetmja mënyrë për të provuar veprat penale, pasi të dhënat mund të nxirreshin nga burime të tjera prove. Sipas tij, asnjë gazetar tjetër, që ka publikuar të njëjtat të dhëna ose persona të tjerë që kishin dijeni për aktet e hetimit nuk u janë nënshtruar kontrolleve dhe sekuestrimeve si kërkuesi. Vendimi gjyqësor për sekuestrimin është formuluar në terma të gjerë dhe ka lejuar sekuestrimin e çdo pajisjeje elektronike, duke u mundësuar hetuesve që të zbulojnë burimet dhe të hyjnë pa kriter në të gjitha të dhënat. Po kështu, sipas kërkuesit, mungojnë masat për të mbrojtur konfidencialitetin e burimeve të gazetarit dhe të informacioneve që nuk lidhen me çështjen, të dhënat janë kontrolluar dhe aksesuar pa praninë e avokatit të tij dhe gjykatat kanë vënë në rrezik jo vetëm marrëdhëniet me burimet e gazetarit, por edhe sinjalizuesit e mundshëm që punojnë në institucionet shtetërore. Po sipas tij, pajisjet e sekuestruara janë sisteme kompjuterike dhe mbartin të dhëna kompjuterike, ndërsa organi i akuzës i ka konsideruar ato si sende. Sipas

kërkuesit, Prokuroria e Posaçme ka aluduar se ai ka kryer krim dhe po abuzon me imunitetin profesional, ndërsa gjykatat e kanë trajtuar rastin sikur gazetari të ishte i pandehur dhe akuzohej për një veprë penale që ishte në tejkalim të lirisë së shprehjes. Kërkuesi ka pretenduar se nuk është thirrur e dëgjuar në seancë gjyqësore për urdhërimin e tregimit të burimit nga gjykata dhe më pas të sekuestrimit, në respektim të nenit 159, paragrafi 3, të KPP-së. Ai gjithashtu ka paraqitur një deklaratë të medias ku është i punësuar si gazetar, sipas së cilës pas datës 13.12.2023 ka pasur një kufizim të ndjeshëm në krijimtarinë investiguese dhe raportuese të gazetarit, përfshirë edhe periodha të konsiderueshme pa raportime, si dhe dalje publike të rralluara ndjeshëm.

40. Subjekti i interesuar ka prapësuar se gjykatat e zakonshme i kanë kthyer përgjigje shteruese, duke argumentuar se ekzistojnë dyshime për veprime penale, pasi publikimi i artikujve përmbante të dhëna sensitive që mund të identifikonin personat e përfshirë në hetime dhe të rrezikonin jetën dhe integritetin e tyre, përfshirë bashkëpunëtorin e drejtësisë. Sipas këtij subjekti, liria e shprehjes është kufizuar me ligj dhe kufizimi është i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Publikimet në media nuk lidhen me raportimin ose zbulimin e një praktike të dyshuar korrupsioni, sjellje joetike ose të jashtëligjshme apo çështje të tjera të mbrojtura nga ligji për sinjalizuesit. Prokuroria e Posaçme ka prapësuar gjithashtu se interesi publik për ruajtjen e fshehtësisë së hetimeve prevalon mbi interesin për të informuar publikun dhe atë për mbrojtjen e burimeve të gazetarit dhe ndonëse gazetarët duhet të jenë të lirë të raportojnë ngjarjet, kërkuesi nuk ka bërë verifikime të mjaftueshme përpara publikimit të informacionit. Sipas subjektit të interesuar, sendet janë sekuestruar për marrjen e informacioneve, të cilat shërbejnë për identifikimin e personave përgjegjës që kanë nxjerrë aktet sekrete të hetimit, me qëllim ndjekjen penale të tyre. Publikimi i të dhënave, sipas subjektit të interesuar, nuk ishte rezultat i një investigimi të një çështjeje me interes publik, pasi nuk shoqërohet me asnjë analizë gazetareske, por thjesht publikim i pjesëve të transkriptimit të bisedave midis bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe të dyshuarve të tjerë për kryerjen e veprave penale.

41. Kushtetuta në nenin 22 garanton lirinë e shprehjes (*pika 1*) dhe në mënyrë specifike lirinë e shtypit, të radios dhe të televizionit (*pika 2*), ndërsa ndalon censurën paraprake të mjeteve të komunikimit (*pika 3*). Kjo liri është e mbrojtur dhe nga neni 10 i KEDNJ-së dhe neni 19 i PNDKP-së.

42. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se liria e shprehjes përbën një nga gurët themelorë të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efikase për të kontrolluar demokracinë si formë e qeverisjes. Nëpërmjet tyre, pushteti shtetëror bëhet më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit. Liria e shprehjes është gjithashtu bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtash dhe lirisë të tjera themelore (*shih vendimet nr. 11, datë 9.3.2021; nr. 56, datë 27.7.2016; nr. 16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Liria e shprehjes është konsideruar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) si një nga themelet kryesore të shoqërisë demokratike, një nga kushtet bazë për përparimin e saj dhe për zhvillimin e çdo individi (*shih Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 7.12.1976, § 49*). Në veçanti për mbrojtjen e burimit të informacionit të një gazetari GJEDNJ-ja ka pohuar se përbën një nga themelet e lirisë së shtypit. Pa një mbrojtje të tillë burimet mund të pengohen të ndihmojnë shtypin në informimin e publikut për çështje me interes publik. Si rezultat, roli jetik i “mbrojtësit publik” të shtypit mund të minohet dhe aftësia e shtypit për të ofruar informacion të saktë dhe të besueshëm mund të ndikohet negativisht. Ndërhyrja në këtë të drejtë mund të justifikohet vetëm në rast të mbrojtjes së interesit publik (*shih Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 27.3.1996, § 39*). E drejta e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre nuk mund të konsiderohet thjesht një privilegj për t'u dhënë ose hequr në varësi të ligjshmërisë ose paligjshmërisë së burimeve të tyre, por është pjesë përbërëse e së drejtës për informacion, që duhet trajtuar me kujdesin më të madh (*shih Nagla kundër Letonisë, datë 16.7.2013 § 97; Tillack kundër Belgjikës, datë 27.11.2007, § 65*).

44. Po kështu, GJEDNJ-ja ka vënë në dukje se urdhrat për të zbuluar burimet e gazetareve potencialisht kanë një ndikim të dëmshëm, jo vetëm për burimin, identiteti i të cilit mund të zbulohet, por edhe për median, reputacioni i së cilës mund të ndikohet negativisht për burimet potenciale të së ardhmes (*shih Sanoma Uitgevers B.V. kundër Holandës [DhM]*, datë 27.11.2007, § 89; *Financial Times Ltd dhe të tjerët kundër Mbretëria e Bashkuar*, datë 15.12.2009, § 70). Masat e marra nga autoritetet publike për të zbuluar burimin e informacionit mund të dekurajojnë individët të cilët kanë informacion në lidhje me një ngjarje dhe dëshirojnë të ndajnë njohuritë e tyre me shtypin (*shih Voskuil kundër Holandës*, datë 22.11.2007, § 71).

45. Në rastin kur gazetaret janë të akuzuar penalisht, GJEDNJ-ja ka pranuar se ata ndonjëherë mund të përballen me konfliktin midis detyrës së përgjithshme për t'iu bindur ligjit penal, ndaj të cilit nuk janë të përjashtuar, si dhe detyrës profesionale për të marrë dhe shpërndarë informacion, në mënyrë që media të luajë rolin thelbësor të rojtarit publik. Në këtë situatë të konfliktit të interesave, koncepti i “gazetarisë së përgjegjshme” kërkon që kurdoherë që një gazetar, sikundër edhe punëdhënësi i tij, duhet të zgjedhë midis dy detyrave dhe ai zgjedh të shkelë detyrimin e ligjit penal, atëherë gazetari duhet të kuptojë që po ndërmerret rrezikun se ndaj tij do të jepen sanksione ligjore, përfshirë ato me karakter penal (*shih Pentikäinen kundër Finlandës [DHM]*, datë 20.11.2015, § 110). GJEDNJ-ja ka theksuar në mënyrë të qëndrueshme se gazetaret nuk mund të përjashtohen nga detyra e tyre për t'iu bindur ligjit penal vetëm mbi bazën se neni 10 u jep atyre mbrojtje (*shih Stoll kundër Zvicrës [DHM]*, datë 10.12.2007, § 102).

46. Në përmbledhje të standardeve të mësipërme dhe duke theksuar se në rastin konkret kërkuesi nuk është gazetar i akuzuar penalisht, Gjykata vë në dukje se liria e shtypit luan rolin jetik të mbrojtësit publik në përparimin e një shoqërie demokratike për ta bërë pushtetin shtetëror më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit. E drejta e gazetarit për të ruajtur burimin e informacionit dhe për të mos e zbuluar atë është një nga kushtet e lirisë së shtypit. Mbrojtja e burimeve të gazetarit është një prej garancive kryesore të lirisë kushtetuese të shtypit, ndaj urdhërimi i gazetarit për të zbuluar burimet e tij mund të jetë në kundërshtim me Kushtetutën, përveçse kur ekziston një bazë e qartë ligjore që e autorizon dhe një interes publik mbizotërues që e dikton atë. Kjo e drejtë e gazetarit krijon kushtet për vendosjen e një marrëdhënieje besimi midis gazetarit dhe informatorit të tij, marrëdhënie që i mundëson gazetarit të marrë informacione për çështje me interes publik, edhe në rastet kur zbulimi i burimit të informacionit mund të jetë i ndaluar me ligj ose do të sillte sanksione të tjera. Mungesa e kësaj mbrojtjeje mund të dekurajojë informatorët për të ndihmuar shtypin për informimin e publikut rreth çështjeve me interes publik. Në këtë kuptim, konfidencialiteti i burimeve të gazetarit mbron jo vetëm gazetarin, por edhe vetë individët që janë burimet që e ndihmojnë gazetarin të informojë qytetarët për çështje me interes publik. E drejta e gazetarit për të mos zbuluar burimet e tij nuk është thjesht një privilegj për t'u dhënë ose hequr në varësi të ligjshmërisë së burimeve, pasi, në thelb ajo mbron edhe të drejtën e informimit të qytetarëve, që është në vetvete interes publik.

47. Nga ana tjetër, Gjykata thekson se e drejta për të mbrojtur një burim të gazetarit, si pjesë e lirisë së shtypit, është një nga elementet thelbësore të funksionimit të sistemit demokratik pluralist, megjithatë ajo mund të kufizohet vetëm me ligj për interes publik mbizotërues ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve në raport të drejtë me gjendjen që e dikton kufizimin dhe pa asgjësuar thelbin e lirisë së shtypit. Kjo nënkupton që kufizimi i kësaj të drejte justifikohet vetëm nëse nuk ekzistojnë mjete alternative për të arritur të njëjtin qëllim, pra që identifikimi i burimit është mjeti i vetëm ose i fundit, në kuptimin që të gjitha mjetet e tjera të mundshme janë shteruar dhe se interesi legjitim për zbulimin e burimit të informacionit është më i rëndësishëm se sa interesi publik për ruajtjen e konfidencialitetit.

48. Në këtë pikëpamje, Gjykata vëren se KPP-ja ka vendosur disa kufizime të tilla që lidhen me lirinë e shtypit dhe burimin e gazetarit. Kështu, neni 103 i këtij kodi parashikon se ndalohet publikimi i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv. Ndërsa neni 159 parashikon se gazetari profesionist nuk mund të detyrohet të

dëshmojë emrat e personave nga të cilat ka marrë të dhënat, përveçse kur ato janë të domosdoshme për të provuar veprën penale; kur vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, gjykata urdhëron gazetarin të tregojë burimin e informacionit të tij. Gjykata çmon se këto kufizime të vendosura me ligj i shërbejnë në mënyrë proporcionale interesit publik të administrimit të mirë të drejtësisë në disa dimensione, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, efektivitetin e ndjekjes penale, gjykimin e drejtë, parimin e prezumimit të pafajësisë, mbrojtjen e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Këto janë interesa të mbrojtur nga ligji, që i shërbejnë jo vetëm palëve dhe subjekteve të një procesi gjyqësor konkret, por edhe publikut në tërësi, për shkak të besimit publik që duhet të gëzojë sistemi gjyqësor kur kryen me efektivitet funksionet kushtetuese të tij.

49. Duke ndjekur këtë linjë arsyetimi, Gjykata thekson se kur zbatohen kufizimet e mësipërme ligjore, argumentet në favor të ruajtjes së sekretit hetimor ose të urdhërimit të gazetarit për të treguar burimet e tij duhet të parashtrohen nga prokuroria dhe gjykatat e zakonshme në mënyrë sa më bindëse që është e mundur, duke treguar njëherazi që ekspozimi i burimit të gazetarit është mjeti jo vetëm i domosdoshëm, por edhe i fundit në dispozicion për të vërtetuar veprën penale dhe për të garantuar efektivitetin e procedimit penal. Me fjalë të tjera, ato duhet të arsyetojnë përpjekjet e kryera për marrjen e të dhënave nga burime të tjera prove dhe pamundësinë e sigurimit të të dhënave të synuara nga burime të tjera, duke treguar në këtë mënyrë se ekspozimi i burimit të gazetarit është mjeti i vetëm për ato të dhëna, të cilat janë të domosdoshme për efektivitetin e procedimit penal, pasi interesi për përfundimin me sukses të tij dhe vënia përpara përgjegjësisë penale është më i lartë në raport me mbrojtjen e burimit të gazetarit, si pjesë e lirisë së shprehjes. Po kështu, gjykatat e zakonshme duhet të dallojnë rastin kur prokuroria po zhvillon hetime që lidhen me një sjellje të supozuar penale të gazetarit nga rasti i hetimeve të cilat kanë si qëllim kryesor marrjen e informacionit lidhur me burimin e gazetarit dhe vetë gazetari nuk ka kryer ndonjë vepër penale. Në këtë rast të fundit, garancitë për ndërhyrje në të drejtën e mbrojtjes së burimit janë më të forta dhe nevoja për arsyetimin bindës të gjykatave është më e lartë.

50. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata do të analizojë nëse vendimet gjyqësore të kontrollit e të sekuestrimit të sendeve dhe të të dhënave kompjuterike kanë kufizuar lirinë e shtypit të kërkuesit, në aspektin e së drejtës për të mbrojtur burimet e gazetarit dhe nëse po, do të vlerësojë më pas nëse kufizimi ka respektuar kriteret e vendosura nga neni 17 i Kushtetutës, sipas të cilit kufizimi duhet të jetë bërë me ligj, për arsye të rëndësishme publike/interes publik, dhe të ketë respektuar parimin e proporcionalitetit.

51. Për sa i takon kufizimit, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, për të konstatuar ndërhyrje në lirinë e shprehjes, është i mjaftueshëm edhe urdhri për të zbuluar burimin e informacionit të gazetarit (*shih Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 27.3.1996, § 28*).

52. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata vëren se kërkuesi është thirrur në ambientet e Prokurorisë së Posaçme në datën 13.12.2023 për t'u pyetur për burimin e informacionit të materialeve që ai kishte publikuar në cilësinë e gazetarit në një media *online*. Pas refuzimit të kërkuesit për të identifikuar burimin e informacionit, brenda së njëjtës ditë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka dhënë vendimin për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, të cilat gjendeshin në pajisjet kompjuterike të sekuestruara si prova materiale gjatë kontrollit të banesës dhe të vendit të punës së kërkuesit, kontroll i lejuar gjithashtu me vendimin e po asaj date të së njëjtës gjykatë. Kërkuesi nuk ishte subjekti ndaj të cilit kishte filluar procedimi penal, pra sekuestrimi i të dhënave kompjuterike kishte për qëllim vetëm identifikimin e burimit. Ashtu siç pohon kërkuesi, parashttrim që nuk është kundërshtuar nga subjekti i interesuar, në të dhënat kompjuterike gjendeshin burimet e informacionit të kërkuesit, që shfrytëzoheshin nga ai në ushtrimin e detyrës së gazetarit. Vendimi gjyqësor për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike u vleftësua i ligjshëm edhe nga gjykatat më të larta, të cilat në arsyetimin e tyre kanë pohuar se kontrolli i vendeve (banesë dhe zyrë) dhe sekuestrimi i të dhënave kompjuterike ndërhynte në lirinë e shprehjes së kërkuesit. Sipas tyre, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike në

pajisjet e sekuestruara si prova materiale gjatë kontrollit ka synuar zbulimin e burimit të informacionit të kërkuarit, në cilësinë e gazetarit dhe më pas gjykimin e personave përgjegjës si autorë të veprave penale të zbulimit të të dhënave sekrete dhe shpalljes së tyre në kundërshtim me ligjin. Në këto rrethana, Gjykata çmon se thirrja e kërkuarit për të treguar burimin e informacionit dhe sekuestrimi i të dhënave kompjuterike nga pajisjet e sekuestruara gjatë kontrollit të vendeve kanë kufizuar lirinë e shtypit, në aspektin e identifikimit të burimeve që ai kishte për shkak të profesionit të gazetarit, ndaj, në vijim, do të analizojë nëse kufizimi është vendosur vetëm me ligj, për një interes publik dhe në mënyrë proporcionale.

53. Kriteri i parë i kufizimit, ai *“vetëm me ligj”*, ka për qëllim të ofrojë garanci sa më të plota në rastin e kufizimeve. Të gjithëshë *“vetëm me ligj”* ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në çmim të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 20, datë 4.4.2014; nr. 20, datë 11.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Në rastin e kërkuarit, ai është thirrur nga prokuroria për të treguar burimin e informacionit dhe brenda së njëjtës ditë, me vendim gjyqësor, është lejuar sekuestrimi i të dhënave kompjuterike në provat materiale të sekuestruara gjatë kontrollit të vendeve (zyrë dhe banesë). Këto veprime hetimore janë kryer në kuadër të procedimit penal për veprat penale “Zbulimi i akteve ose i të dhënave sekrete” dhe “Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 295/a, paragrafi i tretë dhe 313/b, paragrafi i parë, të KP-së, por vetë kërkuari, si gazetar, nuk ishte autor i dyshuar i tyre. Për kryerjen e këtyre veprimeve hetimore, Prokuroria e Posaçme dhe gjykatat janë bazuar në nenet 159, 297 dhe 312 të KPP-së (marrja e të dhënave nga Policia Gjyqësore dhe prokuroria sipas rregullave për marrjen e dëshmisë), si dhe në nenet 208 dhe 208/a të po këtij kodi (sekuestrimi i provave materiale dhe i të dhënave kompjuterike). Në këtë kuptim, Gjykata çmon se kriteri i kufizimit vetëm me ligj është i përmbushur.

55. Kriteri i dytë ka të bëjë me *interesin publik ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve*, për të cilin Gjykata ka theksuar se duhet kuptuar në varësi të situatave të ndryshme që krijohen (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pranuar se për kufizimin e të drejtave themelore përbën interes publik mbrojtja e rendit dhe e sigurisë publike nga veprat penale (*shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 4, datë 23.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese*), sikundër administrimi i mirë i drejtësisë (*shih vendimin nr. 70, datë 27.12.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Në rastin konkret, Gjykata fillimisht vëren se kërkuari ka publikuar të dhëna sekrete hetimore, të cilat pasqyrojnë biseda të transkriptuara të një të pandehuri me disa persona të tjerë në platformën e enkriptuar SkyECC, në kuadër të një procedimi penal për vepra penale të krimit të organizuar, konkretisht për 27 vepra penale të rënda kundër jetës dhe pronës nga një grup i strukturuar kriminal i përbërë nga 34 persona. Personi i pandehur i pasqyruar në këto biseda ka marrë statusin e veçantë të bashkëpunëtorit të drejtësisë, të cilit, sipas ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i garantohet jeta dhe shëndeti personal dhe i familjarëve. Në gjykim nuk u provua që kërkuari të kishte dijeni se të dhënat e publikuara mbuloreshin nga sekreti hetimor, ndërsa subjekti i interesuar pohoi se kërkuari nuk ishte subjekti i procedimit penal. Vetë kërkuari ka pretenduar se qëllimi kryesor i publikimit të komunikimeve ka qenë trysnia mbi prokurorët për t’i trajtuar me seriozitet këto komunikime, të cilat përmbajnë të dhëna serioze të kriminalitetit dhe ku dyshohet se janë të përfshirë një numër i madh personash të botës së krimit dhe persona të lidhur me politikën, biznesin ose median. Sipas tij, publikimi i akteve hetimore synonte t’i tregonte organit të akuzës se informacioni disponohej edhe nga media, ndaj duhej vepruar për të vënë përpara përgjegjësisë penale çdo individ, duke luajtur media në këtë mënyrë funksionin e saj të rojtarit publik.

57. Po kështu, Gjykata vëren se në vendimet e kundërshtuara janë konsideruar si bazë ligjore nenet 208 dhe 208/a të KPP-së, që rregullojnë vetëm sekuestron provuese, pa iu referuar sekuestros preventive. Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se sekuestrimi i të dhënave kompjuterike ka pasur

qëllim jo vetëm mbledhjen e provave për vërtetimin e veprës penale, por edhe parandalimin e mëtejshëm të rrjedhjes së akteve sekrete, në kuptim të identifikimit të burimit të rrjedhjes së akteve sekrete, si dhe mbrojtjen e jetës së shtetasve të tjerë (bashkëpunëtorit të drejtësisë). Një qëndrim i tillë u pohua edhe nga subjekti i interesuar në prapësimet me shkrim dhe në seancën publike.

58. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se gjatë shqyrtimit të akteve ajo nuk analizon thjesht bazën juridike të referuar, por objektin dhe përmbajtjen e tyre (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*), arrin në përfundimin se pyetja e kërkuesit për identifikimin e burimit dhe sekuestrimi i të dhënave kompjuterike të tij, të cilat kanë ndërhyrë në lirinë e shtypit, kanë pasur qëllime legjitime të administrimit të mirë të drejtësisë, mbrojtjes së rendit dhe të sigurisë publike, si dhe të të drejtave themelore të të tjerëve, të cilat janë vlera që duhen mbrojtur në një shoqëri demokratike. Këto kufizime, përveç mbledhjes së provave, duket se kanë synuar edhe ndalimin e rrjedhjes së informacioneve të mbuluara nga sekreti hetimor që lidhen me një hetim në proces të krimit të organizuar dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale ndaj bashkëpunëtorit të drejtësisë, familjarëve të tij ose personave të tjerë, të cilët vihen në dijeni të fakteve të ndryshme nga bisedat e publikuara. Në këtë rast, bëhet fjalë për interesa të cilat edhe vetë ligji i merr në mbrojtje, kur parashikon procedurat e mbrojtjes së dëshmitarit të drejtësisë, procedurat e sekretimit të akteve hetimore, rregullat për pyetjen për burimin e informacionit deri te kontrollat dhe sekuestrimin e sendeve dhe të të dhënave kompjuterike. Ashtu siç u theksua më lart, e drejta e mbrojtjes së burimit të gazetarit, pavarësisht ligjshmërisë së burimit, nuk është privilegj, por i shërben interesit publik të informimit të qytetarëve. Megjithatë kjo e drejtë mund të kufizohet për interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve (*shih paragrafin 47 të vendimit*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se në rastin e kërkuesit përmbushet edhe kriteri i dytë i kufizimit që ka të bëjë me qëllimin legjitim¹.

59. Kriteri i tretë i kufizimit ka të bëjë me *proporcionalitetin e ndërhyrjes*, në thelb të të cilit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes merret në shqyrtim balanca ndërmjet dëmit të shkaktuar individit dhe së mirës së përgjithshme të shoqërisë, masa e mbrojtjes nga arbitrariteti që ofrojnë procedurat ligjore, si dhe mundësia e shtetit për të përdorur mënyra ose mjete të tjera për të arritur qëllimin. Shteti, brenda mundësive, duhet të kufizojë ndërhyrjen në minimum, duke kërkuar zgjidhje alternative dhe, përgjithësisht, duke u përpjekur t'i arrijë qëllimet në mënyrë sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

¹ Gjyqtarja Sonila Bejtja, ndryshe nga shumica, mbajti qëndrimin se në rastin konkret nuk plotësohet kriteri “*për interes publik*”. Në vlerësimin e saj, edhe pse procedimi penal në vetvete mbart interesin publik, kjo nuk shoqëron edhe çdo veprim konkret që kryhet në kuadër të atij procedimi, por kërkon një vlerësim rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete. Në këtë kuptim, sekuestrimi i sendeve të kërkuesit ka pasur si qëllim zbulimin e burimit të informacionit të tij (rrjedhjen e informacionit “sekret hetimor”), pra identifikimin e individit që ka nxjerrë të dhënat e hetimit të klasifikuara si “sekret hetimor” me qëllim procedimin penal të tij, por nuk duket se mbart një interes publik të përgjithshëm. I ndryshëm do të ishte qëndrimi në rast se do të ishim përpara sekuestros preventive që synon parandalimin e ardhjes së këtyre pasojave, pra që synon të evitojë publikimin e këtyre të dhënave dhe që do të mbartte interesin publik të lidhur me rrezikun për sigurinë kombëtare e rendin publik ose edhe jetën e shëndetit e bashkëpunëtorit të drejtësisë. Në rastin konkret, ruajtja e informacionit të klasifikuar nga vetë organi i akuzës si “sekret hetimor” është detyrë dhe përgjegjësi e rëndësishme e këtij institucioni, pasi është një nga elementet më delikate të veprimtarisë së përditshme të tij e që ka të bëjë edhe me detyrimin (në cilësinë e mbajtësit të parë të këtyre informacioneve) për të garantuar ruajtjen nga publikimi apo rrjedhja e informacioneve të ndjeshme të klasifikuara “sekret hetimor”. Për këto arsye, detyra e “ruajtjes së informacionit sekret hetimor” nga ana e organit të akuzës nuk mund të konsiderohet si “interes publik”, por si detyrë parësore e këtij institucioni. Për rrjedhojë, për sa kohë që konsiderohet se kjo masë nuk përmbush kriterin e kufizimit për interes publik kjo ishte e mjaftueshme për shfuqizimin e saj për këtë shkak, pa pasur nevojë për të vijuar më tej me analizën e kriterit të proporcionalitetit.

60. Edhe GJEDNJ-ja në drejtim të proporcionalitetit ka analizuar mjetet e përdorura për ndërhyrjen në lirinë e shprehjes së gazetarit, duke filluar nga urdhri për të zbuluar burimin e informacionit, i cili jo vetëm potencialisht ka një ndikim negativ te burimi i informacionit, të cilit i zbulohet identiteti, por edhe te reputacioni i gazetarit ose i medias (*shih Sanoma Uitgevers B.V. kundër Holandës [DhM]*, datë 27.11.2007, § 89); kontrolli i vendeve dhe sekuestrimi, si një masë më drastike, pasi aksesohet në mënyrë të plotë në të gjitha dokumentet e gazetarit (*shih Roemen dhe Schmit kundër Luksemburgut*, datë 25.2.2003, § 57); vendosja nën mbikëqyrje e gazetarit, nëse ajo miratohet nëpërmjet një vendimi gjyqësor përpara vendosjen nën mbikëqyrje ose pas (*shih Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.V. dhe të tjerë kundër Holandës*, datë 22.11.2012, §§ 97, 98); dhe detyrimi për të dëshmuar në kuadër të një procesi penal, nëse justifikohet nga interesi publik (*shih Becker kundër Norvegjisë*, datë 5.10.2017, § 83).

61. Po kështu, GJEDNJ-ja ka vendosur në disa raste se kontrolli i kryer me qëllim zbulimin e burimit të një gazetari është një masë më drastike se sa urdhri për të zbuluar identitetin e burimit. Kjo për shkak se hetuesit që kontrollojnë vendin e punës së një gazetari pa paralajmërim dhe të pajisur me urdhër sekuestrimi kanë kompetenca shumë të gjera hetimore, pasi kanë akses në të gjithë dokumentacionin e mbajtur nga gazetari (*shih Roemen dhe Schmit kundër Luksemburgut*, datë 25.2.2003, § 57; *Ernst dhe të tjerët kundër Belgjikës*, datë 15.7.2003, § 103). Në një rast GJEDNJ-ja është shprehur se kontrolli i kryer në ambientet profesionale të gazetarëve, kopjimi në disqe të jashtme të të gjithë përmbajtjes së kompjuterëve tyre dhe mbajtja e këtyre disqeve nga prokuroria kërcënonte mbrojtjen e burimeve në një shkallë të lartë. Marrja pa dallim e të gjitha të dhënave në paketat *software* u kishte mundësuar autoriteteve të mblidhnin informacione që nuk kishin lidhje me rastin në fjalë (*shih Görmüş dhe të tjerët kundër Turqisë*, datë 19.1.2016, § 73).

62. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata fillimisht vëren se rregullat procedurale penale për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike janë shtuar në KPP në vitin 2008 dhe nuk kanë pësuar ndryshime të tjera, pavarësisht zhvillimit të vullshëm që ka njohur teknologjia e informacionit. Ndonëse ligjvënësi nuk ka ndërhyrë, përmbajtja e dispozitave procedurale penale është zhvilluar nga Gjykata e Lartë me anë të vendimit njësoj nr. 147/2021, në të cilin janë përcaktuar kritere të detajuara për sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike, kritere që janë në një linjë me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira në këtë drejtim. Po kështu, subjekti i interesuar shpjegoi në seancë plenare se Prokuroria e Posaçme vepron në praktikë, duke iu referuar procedurave standarde të ekzaminimit kompjuterik të Policisë Shkencore, udhëzimit të INTERPOL-it, si dhe disa guidave dhe udhëzuesve të Këshillit të Evropës. Në këtë pikë, ndonëse vjetrimi i normës nuk përbën *per se* shkak për cenimin e të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 69*, datë 27.12.2023, të Gjykatës Kushtetuese), Gjykata sjell në vëmendje nevojën e përditësimit në të ardhmen nga ligjvënësi të rregullave ligjore që lidhen me procedurën e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, të cilat duhet t'u përgjigjen si duhet zhvillimeve aktuale të teknologjisë së informacionit, nevojës për hetime efektive, por mbi të gjitha mbrojtjes efektive të lirive themelore të individit. Kjo me qëllim garantimin e një kornize ligjore të qartë dhe të saktë për administrimin dhe përpunimin e të dhënave elektronike të marra gjatë sekuestrimit të tyre.

63. Në vijim të analizës së kriterit të proporcionalitetit, Gjykata, duke u bazuar në standardet kushtetuese dhe konventore, do të shqyrtojë nëse ndërhyrja në lirinë e shtypit dhe të drejtën e kërkuesit për të mbrojtur burimet e tij ka qenë mjeti i fundit dhe i vetëm në dispozicion të prokurorisë dhe gjykatave të zakonshme, si dhe nëse qëllimi legjitim i ndërhyrjes ka qenë mbizotërues. Për qëllime të kësaj analize, Gjykata do të verifikojë detyrimet e përcaktuara nga ligji për organin procedues dhe se si janë zbatuar ato në rastin konkret.

64. Veprimet e prokurorisë për të verifikuar të dhënat nga kërkuesi, në cilësinë e gazetarit profesionist, bazohen në nenet 159, 297 dhe 312 të KPP-së, sipas të cilave Policia Gjyqësore ose prokurori mund të marrin të dhëna nga gazetari profesionist për burimin e informacionit, nëse ato (të dhënat) janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e tyre mund të dalë vetëm

nëpërmjet identifikimit të burimit. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, është e qartë që ligjvënësi ka zbatuar parimin e proporcionalitetit në ndërhyrjen e së drejtës për të mos treguar burimin e gazetarit, pasi ka vënë theksin jo vetëm te domosdoshmëria, por edhe te fakti që identifikimi i burimit është mjeti i vetëm për të provuar faktet penale.

65. Nën këtë optikë, Gjykata eidenton se në datat 10.12.2023 dhe 11.12.2023 kërkuesi ka publikuar artikuj, në të cilat pasqyroheshin të dhëna që u përkisnin akteve të hetimit paraprak të prokurorisë. Në datën 11.12.2023, prokuroria regjistroi procedimin penal dhe të nesërmen, më 13.12.2023, ora 11:00, kërkuesi është thirrur në Prokurorinë e Posaçme ku fillimisht ka nënshkruar një deklaratë për ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimeve të akteve sekrete ose të dhënave që përmbanin këto akte që i përkasin procedimit penal nr. 75/2022, detyrim të cilin ai e ka pohuar në seancën plenare se e ka respektuar dhe që nuk është kundërshtuar nga subjekti i interesuar. Ndërkohë, po në datën 13.12.2023, ora 15:15, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka miratuar kërkesën e prokurorit për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, vendim i cili është ekzekutuar në orën 20:20 (në prani të kërkuesit) në banesë dhe në orën 22:30 në vendin e punës. Ndërkohë, nga të dhënat bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, rezulton se kërkuesi ka qëndruar në Prokurorinë e Posaçme deri rreth orës 18:00. Ndërsa me urdhrin e datës 14.12.2023 Prokuroria e Posaçme ka urdhëruar kërkuesin për ruajtjen e sekretit, ndalimin e publikimit të akteve dhe përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit dhe informacionit masiv për sa i përket procedimit penal nr. 75/2022 dhe se në rast moszbatimi ai do të mbante përgjegjësi penale, sipas nenit 295/a, paragrafët 4 dhe 5, të KP-së.

66. Pa pritur efektet e urdhrin për ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimit të akteve, dhe pa pasur ndonjë indicie që ky urdhër nuk do të zbatohet nga kërkuesi në cilësinë e gazetarit, prokuroria brenda pak orësh ka paraqitur në gjykatë kërkesat për kontrolle dhe sekuestrim të sendeve dhe provave materiale, kërkesa të cilat janë pranuar.

67. Në vlerësimin e Gjykatës dhe duke mbajtur në konsideratë qëllimet legjitime të sekuestrimit të të dhënave kompjuterike (*shih paragrafin 58 të vendimit*), kjo mënyrë veprimi e organit procedues (prokurorisë dhe gjykatave) nuk ka qenë në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë. Kështu, për sa i takon qëllimit legjitim të parandalimit të rrjedhjes së informacionit dhe të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të bashkëpunëtorit të drejtësisë (qëllimi i sekuestros preventive), duket që prokuroria dhe gjykatat e zakonshme kanë vepruar pa pritur efektet e urdhrin të sekretit hetimor, dhe për rrjedhojë edhe pa analizuar përse ishte e nevojshme të përdorej me urgjencë mjeti i fundit, ai i sekuestrimit. Po ashtu, për sa i takon qëllimit legjitim të vërtetimit të veprave penale që po hetoheshin (sekuestro provuese), gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar se përse marrja e të dhënave të nevojshme për hetimin mund të realizohej vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit të gazetarit, si mjet i fundit dhe i vetëm, pra përse nuk ekzistonin mjete të tjera alternative për të arritur qëllimin provues të sekuestros. Gjithashtu, nga përmbajtja e këtyre vendimeve, nuk rezulton e pasqyruar as analiza e urgjencës në sekuestrimin e të dhënave kompjuterike të kërkuesit. Për më tepër, vetë kërkuesi nuk rezulton të ishte subjekt i procedimit penal, siç u pohua shprehimisht nga subjekti i interesuar në seancë plenare. Me fjalë të tjera, gjykatat e zakonshme nuk kanë mbajtur në konsideratë se e drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetarit nuk është thjesht një privilegj për t'u dhënë ose hequr në varësi të ligjshmërisë ose paligjshmërisë së burimeve të tyre, por është pjesë përbërëse e së drejtës për informacion, që duhet trajtuar me kujdesin më të madh dhe se urdhri për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike potencialisht ka pasur ndikim të dëmshëm jo vetëm për kërkuesin dhe burimet e tij, por edhe për median në tërësi.

68. Për sa më lart, Gjykata çmon se gjatë gjykimit, nuk u arrit të provohet se prokuroria ka ndërmarrë veprime të tjera hetimore të mjaftueshme për zbulimin e autorëve të dyshuar të veprave penale, të cilët, referuar veprave penale, janë subjekte të posaçme, prokurori ose oficeri i Policisë Gjyqësore ose zyrtarë të tjerë me akses në aktet sekrete të hetimit. Për këta të fundit nuk u tregua që, përpara kryerjes së veprimeve hetimore ndaj kërkuesit, të ishin kryer veprime hetimore. Nga ana tjetër, ndonëse prokuroria dhe gjykatat e zakonshme kanë vepruar ndaj kërkuesit brenda 24 orëve,

prokurorët e çështjes janë ndërruar pas 8 muajve të hetimeve paraprake. Po kështu, Gjykata mban në vëmendje edhe faktin se, sikurse është pohuar nga subjekti i interesuar në seancën publike të datës 2.4.2025, hetimet për këto vepra penale (nenet 295/a dhe 312 të KP-së) ende nuk kanë përfunduar. Kohëzgjatja e hetimeve për pothuajse një vit e gjysmë në raport me urgjencën prej 24 orësh të kryerjes së veprimeve ndërhyrëse në burimet e informacionit të kërkuesit është tregues i qartë se sekuestrimi i të dhënave kompjuterike të tij nuk ka qenë mjeti i fundit hetimor, por ndër të parat për të kërkuar burimin e zbulimit të akteve sekrete hetimore.

69. Nga ana tjetër, për sa i përket mënyrës së aksesimit në të dhënat kompjuterike të sekuestruara, kërkuesi u shpreh se i ka mundur hetuesve që të zbulojnë burimet dhe të hyjnë pa kriter në të gjithë të dhënat, pa pasur garanci mbrojtëse të burimeve të gazetarit dhe të sinjalizuesve, përfshirë mungesën e mbrojtësit. Ndërsa subjekti i interesuar ka sqaruar se në funksion të këqyrjes janë hapur në mënyrë elektronike të dhënat dhe më pas është vijuar me këqyrjen e tyre, ku janë përdorur për analizimin mundësitë që ofron programi i aksesimit të të dhënave. Këto veprime janë kryer pa praninë e avokatit të kërkuesit, por edhe vetë prokurori nuk ka qenë i pranishëm. Sipas subjektit të interesuar, të dhënat nuk mund të kërkohej vetëm me fjalë kyçe për vetë aspektin teknik, pasi ka të dhëna elektronike të cilat nuk janë të kërkueshme, si fotografitë, komunikimet e koduara ose dokumente të formatit “pdf”. Për këtë shkak, e vetmja mënyrë, sipas subjektit të interesuar, është analiza e përmbajtjes së këtyre të dhënave, duke evidentuar vetëm ato raste kur gjenden të dhënat me interes në funksion të hetimeve. Po kështu, ky subjekt ka sqaruar se të dhënat janë nxjerrë dhe janë kopjuar në një *hard disk* të jashtëm që i është bashkëlidhur akteve të ekspertimit.

70. Në lidhje me sa më sipër, ndonëse nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara rezulton se është urdhëruar ruajtja dhe sekuestrimi vetëm i atyre të dhënave të cilat lidhen me veprat penale për të cilat po hetohet, ky fakt nuk përjashton cenimin e lirisë së shprehjes së kërkuesit, si masë e fundit. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se pavarësisht deklarimeve të subjektit të interesuar (si në parashtrime, ashtu edhe gjatë seancës plenare), për mënyrën e këqyrjes të të dhënave kompjuterike, kërkuesit nuk i janë ofruar garancitë e nevojshme kushtetuese dhe konventore, me natyrë procedurale, për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe ruajtjen e burimeve të tjera të informacionit, ose materialeve konfidenciale, të cilat nuk lidhen me hetimin në fjalë, duke sjellë, për pasojë, shkeljen e kësaj lirie.

71. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë së shprehjes është i bazuar, prandaj vendimet objekt shqyrtimi duhen shfuqizuar.

72. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për jetë private, Gjykata vlerëson të mos ndalet në shqyrtimin e tij, për sa kohë ajo gjeti shkelje në lirinë e shprehjes së kërkuesit, duke shfuqizuar vendimet e mësipërme.

73. Për sa i përket kërkesës për shkatërrimin e të gjitha kopjeve të imazheve të kopjuara, të të dhënave kompjuterike, kërkuesi ka pretenduar marrjen e masave deri në shkatërrimin e plotë të të gjitha kopjeve të imazheve të hard disqeve të kompjuterëve dhe USB-ve, ndalimin e çdo aksesimi eventual, kryerjen e çdo procedure filtrimi dhe/ose përzgjedhjeje të të dhënave, si dhe nxjerrjes së kopjeve të tjera. Për sa i përket kësaj kërkesë, bazuar në gjetjen e mësipërme për konstatimin si të bazuar të pretendimeve të kërkuesit për cenimin e lirisë së shprehjes, Gjykata çmon se pretendimi për shkatërrimin e kopjeve të imazheve është i bazuar, ndaj kërkesa pranohet. Për rrjedhojë, Gjykata urdhëron asgjësimin e të dhënave kompjuterike të sekuestruara në provat materiale të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës dhe vendit të punës së kërkuesit.

74. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara, sipas arsytimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 501, datë 13.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 04 (87-2024-9), datë 6.1.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nr. 00-2024-255 (36), datë 20.2.2024, të Gjykatës së Lartë.
3. Asgjësimin e të dhënave kompjuterike të sekuestruara me vendimet e mësipërme, sipas arsyetimit të këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 22.4.2025.

Shpallur më 21.5.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini